



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 274/8 Prot

Tiranë më 05 . 05 . 2015

V E N D I M

Nr. 46 , datë 05/05/2015

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil
Inspektorati Shtetëror i Arsimit**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), si dhe neneve 80-104 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit,

VËREJ SE:

Në zbatim të vendimit nr. 30, datë 23.03.2015 "Për një shtesë në vendimin nr. 14, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar kryesisht mbikëqyrjen e përgjithëshme, për administrimin e shërbimit civil në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit".

Objekti i mbikëqyrjes përfshin monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore, gjatë aplikimit në praktikë të instituteve të tij, sipas një programi të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Në vijim të procesit, grupi i mbikëqyrjes, ka administruar materialet e nevojshme për të arritur në konkluzione të sakta, ka mbledhur dhe analizuar të dhënat në lidhje me drejtimet e mbikëqyrjes, të materializuara në aneksrportet që janë pjesë e këtij vendimi dhe në përfundim ka hartuar projektraportin, i cili i është dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 274/4, datë 21.04.2015 "Dërgohet projektraporti", duke i lënë 3 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me materialin.

Sipas akteve të administruara, rezulton se me shkresën nr. 275/1, datë 24.02.2015, "Kthim projektraporti", Inspektorati Shtetëror i Arsimit, është shprehur dakort me përmbajtjen e

projektraportit dhe nuk ka shprehur komente apo objeksione lidhur me përmbajtjen e tij. Projektraporti është i firmosur nga titullari i institucionit (*ISHA*) dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore në institucion.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij dhe vlerësoj se procesi është kryer në përputhje me normat dhe rregullat e përcaktuara në “*Rregulloren mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë. 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Në këto rrethana, Komisioneri vijon me shqyrtimin e përmbajtjes së raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës dhe në përfundim të këtij procesi, vlerëson se duhet të miratojë përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, të kryer në institucionin, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Për këtë vendim të njoftohet Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave, si dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA